

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Trump te liderët e tjerë, sa fitojnë udhëheqësit botërorë? Paga më e lartë prej miliona dollarë vjen nga një vend i vogël
ADRESA	https://piranjat.al/bota/sa-fitojne-udheheqesit-boterore-nga-trump-te-lideret-e-tjere-ja-sa-paguhen--i103494
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 15:54:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 15:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3c062a9ecfab7bf72e17a98378e961afa37fe8d22e163c13c9d56b5acc0bf0ea
TEKSTI	9119c218beb6f13412917a2bc6dae4265f371136904c23127145e4c7a5dadb80
PAMJA	0cf6e17828813cdf8225b78bca720fa6ef3737880a35b9b9573dca242d9f4d6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a4df4f88bbcb2c118cb3ccd2db43b5be869cf3d6d64fae11a32e6be990e5f7ef
E MËPARSHMJA	b68078e08c1d93ed3a4d80c0f4cd595c5a57ed4e8bc12e10b1d0870d5b2afcd9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a4df4f88bbcb2c118cb3ccd2db43b5be869cf3d6d64fae11a32e6be990e5f7ef

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

 [SYRI LIVE](#)



Flash:

[regjistroi në emrin e](#)

[kombëtares Igli Tare dyshohet](#)

[parakusht i panegociueshëm](#)

[trugën për integrimin në B...](#)

[të riut italian!](#)

[te rin, i cili në kohën e neqaries](#)

[e George Kamuras-it](#)

[Kapiteni 36-vjeçar i](#)

[trajnere e skuadrës](#)

[trajneren e re të skuadrës së](#)

 BOTA

Nga Trump te liderët e tjerë, sa fitojnë udhëheqësit botërorë? Paga më e lartë prej miliona dollarë vjen nga një vend i vogël

Piranjat Përditësimi i fundit 10 Shtator 2026, 17:53



 Nga Trump te liderët e tjerë, sa fitojnë udhëheqësit

Rasti i Singaporit ka rikthyer vëmendjen te një temë që periodikisht bëhet pjesë e debatit: sa fitojnë presidentët, kryeministrat dhe drejtuesit e qeverive në botë?

Kryeministri i Singaporit, Lawrence Wong, ishte tashmë lideri politik më i paguar në nivel ndërkombëtar dhe, me rritjen e re të miratuar nga qeveria, diferenca me homologët e tij në vendet e tjera pritet të thellohet edhe më tej.

Paga e tij vjetore do të rritet nga 2.2 milionë në 3.6 milionë dollarë singaporianë, të barabarta me rreth 2.8 milionë dollarë amerikanë.

Por sa fitojnë liderët e tjerë botërorë? Një përmblendje e bërë nga BBC-ja tregon se sa jashtëzakonisht i lartë është niveli i pagës në Singapor krahasuar me shpërblyerit që marrin drejtuesit e vendeve të tjera.

Nga Hong Kongu te Shtetet e Bashkuara: kush paguhet më shumë pas Wong?

Sipas të dhënave të raportuara nga BBC-ja, pas Wong renditet kreu i Ekzekutivit të Hong Kongut, John Lee, me një pagë prej rreth 719 mijë dollarësh amerikanë në vit.

Pas tij vjen presidenti i Konfederatës Zvicerane, Guy Parmelin, me rreth 606 mijë dollarë në vit.

Në Shtetet e Bashkuara, presidenti Donald Trump merr një pagë prej 400 mijë dollarësh në vit, ndërsa kryeministri britanik Andy Burnham arrin rreth 230 mijë dollarë.

Krahasimi e bën të qartë diferencën e madhe me Singaporin: edhe lideri i dytë në renditjen e paraqitur nga BBC-ja fiton pak më shumë se një të katërtën e 2.8 milionë dollarëve amerikanë që Wong do të marrë me sistemin e ri.

Megjithatë, krahasimi i pagave të liderëve nuk është gjithmonë i drejtpërdrejtë. Nga njëri vend në tjetrin ndryshojnë rregullat, kompensimet shesë, mundësia për të mbajtur disa poste njëkohësisht, madje edhe vetë natyra e pagesës.

Sa fitojnë Meloni dhe Mattarella

Në Itali, për shembull, sistemi bën një dallim të qartë mes pagës që lidhet me postin qeveritar dhe pagës parlamentare.

Deklarata e fundit e të ardhurave të Giorgia Melonit, e dorëzuar në vitin 2025 dhe që i referohet vitit 2024, tregon të ardhura totale prej rreth 180 mijë eurosh, shumë më pak se 459 mijë eurot e vitit paraardhës, kur në total kishin ndikuar më shumë edhe të ardhurat nga librat e saj. Bëhet fjalë për 180 mijë euro bruto, por kjo shumë nuk përfaqëson pagën e saj si kryeministre, por totalin e të ardhurave mbi të cilat llogaritet tatimi.

Në fakt, të ardhurat totale nuk përkojnë me pagën që lidhet me aktivitetin politik. Meloni është deputete dhe, pikërisht sepse është anëtare e Parlamentit, nuk merr një pagë të dytë për postin e kryeministres. Që nga viti 2013 është hequr trajtimi i dyfishtë financiar për parlamentarët që bëhen pjesë e qeverisë.

Paga e një deputeti aktualisht është 10.435 euro bruto në muaj, për 12 muaj, ose rreth 125 mijë euro bruto në vit, ndërsa paga neto mund të jetë rreth 80 mijë euro në vit. Kësaj shume i shtohen dietat dhe rimbursimet për ushtrimin e mandatit, të cilat megjithatë nuk duhet të ngatërrohen me pagën.

Sistemi ndryshon për një kryeministër që nuk është deputet. Në këtë rast zbatohen rregullat për trajtimin financiar të anëtarëve të qeverisë.

Ndryshe është edhe rasti i kreut të shtetit. Paga e parashikuar për presidentin e Republikës së Italisë është 239.182 euro bruto në vit, por Sergio Mattarella ka zgjedhur ta reduktojë atë me rreth 60 mijë euro, duke marrë parasysh pensionin që ka përfutur si profesor universiteti.

Kështu, shuma që Mattarella merr realisht është 179.835,84 euro bruto në vit.

Mattarella ka hequr dorë gjithashtu nga përshtatja e pagës me inflacionin dhe nuk merr pensionin e përjetshëm si ish-deputet.

Nga Merz te Macron dhe Sánchez, pagat e liderëve europianë

Edhe mes vendeve kryesore europiane, diferenat janë të konsiderueshme. Në Gjermani, Friedrich Merz renditet në kategorinë e pagave më të larta. Paga bazë e kancelarit, e llogaritur mbi kategorinë e pagave B11 të përcaktuar nga ligji gjerman, është rreth 26.807 euro bruto në muaj, ose afërsisht 322 mijë euro në vit.

Merz është gjithashtu deputet në Bundestag dhe mund të mbajë 50% të pagës parlamentare. Që nga korriku 2026, kjo pagë është 12.330,48 euro në muaj, ndaj kancelarit i takojnë rreth 6.165 euro në muaj, përveç kompensimeve të tjera dhe rimbursimeve të parashikuara.

Më e ulët është paga e presidentit francez Emmanuel Macron, i cili merr rreth 16.039 euro bruto në muaj, ose pak më shumë se 192 mijë euro bruto në vit. Kjo shumë përfshin pagën bazë, si dhe kompensimet për funksionin dhe qëndrimin, të parashikuara nga ligji francez.

Në Spanjë, ndërkohë, të dhënat e fundit të publikuara nga portali i transparencës tregojnë se presidenti i qeverisë, Pedro Sánchez, ka marrë një pagë prej 95.943,96 euro bruto në vit në 2025.

Sánchez është gjithashtu deputet, por nuk mund të marrë një pagë të dytë nga shteti. Megjithatë, ai vazhdon të përftojë kompensimin për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me ushtrimin e mandatit parlamentar. /PiranjatNews/

Artikuj te sugjeruar

BOTA 10 Shtator15:42

BE rregulla të reja për qiratë ditore: Qytetet mund të kufizojnë kur Airbnb rëndon krizën e strehimit

Bashkimi Europian po përgatit rregulla të reja për qiratë afatshkurtra turistike, të ofruara përmes platformave si Airbnb dhe Bo...

BOTA 10 Shtator15:31

Skandal me "call-centerat" në Ukrainë, DW: Të përfshirë zyrtarë të Prokurorisë

Autoritetet ukrainase kundër korrupsionit, NABU dhe SAPO, kanë nisur një aksion ndaj zyrtarëve të Prokurorisë së Përgj...

BOTA 10 Shtator15:20

Si po i ndihmon Al-Kaida sulmet e militantëve në Pakistan

Në maj, një shpërthim në një pikë kontrolli të policisë në veriperëndim të Pakistanit u pasua nga një&eu...

BOTA 10 Shtator15:10

Energjia dhe karburantet shtrenjtojnë jetesën në Gjermani, inflacioni pranë 3%

Lufta me Iranin ka rritur çmimet e energjisë dhe, si pasojë, ka shtrenjtuar jetesën në Gjermani. Çmimet që paguajn&eu...

BOTA 10 Shtator15:00

Agjencitë ballkanike të lajmeve bashkë kundër "Fake News" dhe mbrojtje të lirisë së shtypit

Lufta kundër lajmeve të rreme (Fake News), mbrojtja e lirisë së shtypit dhe garantimi i së drejtës së qytetarëve p&eu...

BOTA 10 Shtator14:26

Gushti thyen rekordet e temperaturave, bota përjeton muajin më të nxehtë në histori

Shkencëtarët kanë bërë të ditur se gushti i vitit 2026 ishte ndër muajt më të nxehtë të regjistruar ndo...

BOTA 10 Shtator12:09

Thirrje urgjente Brukselit/ Mbi 100 eurodeputetë kërkojnë zhbllokimin e 200 miliardë eurove asete ruse për Ukrainën

Më shumë se 100 eurodeputetë nga të gjitha grupet kryesore politike i kanë dërguar një letër të përbashk&eu...

BOTA 10 Shtator11:33

Merz akuzon AfD-në për "spastrim etnik", anulon telefonatën me Trump pasi uroi ekstremistët

Kancelari i Gjermanisë, Friedrich Merz , ka akuzuar partinë e ekstremit të djathtë Alternative für Deutschland (AfD) se kërkon &...

BOTA 10 Shtator11:30

Huthët marrin kontrollin e Muhas në Jemen, pse qyteti është me rëndësi strategjike

Rebelët Huthi kanë marrë të enjten kontrollin e qytetit portual të Muhas në Jemen, sipas tre burimeve qeveritare jemenase që...

BOTA 10 Shtator09:44

Si aleatët e NATO-s penguan komplotin rus të sabotimit të kabllove nëndetëse

Thellë në ujërat e Arktikut pranë arkipelagut të largët Svalbard këtë pranverë, aleatët e NATO-s kapën ...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 9 Shtator

Kush qëllloi i pari? Ekspertiza zbulon të vërtet...

Dyshohet se ka qenë Valentina Pambianco ajo që ka marrë armën dhe ka tërhequr këmbëzën, duke vrarë bashkësho...

AKTUALITET 10 Shtator

Dhunohet drejtori i Ujësjiellësit të Elbasanit, ...

Dhunohet drejtori i Ujësjiellësit të Elbasanit, Luan Tabaku. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 10:45 të mëngjesit të së die...

[Kontrolle ndaj makinave luksoze në Lezhë/ Bllok...](#)

Strukturat e Policisë së Lezhës kanë nisur një aksion të përqendruar ndaj automjeteve luksoze që qarkullojnë në...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.





5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënien të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin në autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtonte "shërim" me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijëve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënua për "shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën "Durrës Marina" dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë "copy-paste"/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i 'errët' i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



"Na detyruan nga Dubai"/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi



Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.